

Zhivko Avramovski

EKSPLOATIMI GJERMAN I MINIERAVE TË KROMIT NË RAJONIN E GJAKOVËS DHE TË KUKËSIT PAS KAPITULIMIT TË ITALISË (1943-1944)

(Vazhdim)

Aftësimi dhe eksploatimi i minierave të kromit në rajonin Gjakovë — Kukës

Punimet në aftësimin dhe eksploatimin e minierave të xehes së kromit në rajonin e Gjakovës e të Kukësit filluan që në tetor të vitit 1943. Shtabi ushtarak-ekonomik i Armatës së dytë të blinduar i la në dispozicion Südost-Montanit një kompani (çetë) të batalionit 26 teknik të motorizuar (mekanizuar). Meqë sipas vendimit të të autorizuarit special për Juglindje, Nojbaherit, marrëveshjen për eksploatimin e minierave të kromit është dashur ta përfundojë me qeverinë shqiptare kompania Südost-Montan në baza private-kapitaliste, u arrit marrëveshje midis Nojbaherit, udhëheqësit ekonomik të Armatës së dytë të blinduar të Kosovës dhe përfaqësuesit të përgjithshëm të autorizuar gjerman në Shqipëri, Zauervajnit (Sauerwein), që për financimin e punës së minierave ka për t'u kujdesur Südost-Montani me mbështetjen e Konsulatës së përgjithshme gjermane në Tiranë. Südost-Montani, po ashtu është dashur të sigurojë sasi të mjaftueshme artikujsh ushqimi për punëtorë dhe personelin tjetër për periudhën e dimërit, kur blerja dhe transportimi ishin punë jashtëzakonisht të rënda. Udhëheqësi ushtarak-ekonomik i Armatës së dytë të blinduar është dashur të sigurojë liferime plotësuese të artikujve ushqimorë prej rezervave të armatës. Ai po ashtu ka pasur për detyrë të ndihmojë sigurimin e hapësirës së mjaftueshme në komunikacionin hekurudhor dhe rrugor për transportimin e xehes deri në stacionet hekurudhore në Pejë, Ferizaj, Lipjan dhe në Strugë dhe mëtej me hekurudhë deri në Gjermani. Për shkak të lokacionit të puseve xeherore në vise malore të paafërueshme dhe të mosekzistimit të rrugëve afruese të mira, ku do të mund të lëviznin kamionat, prej minierave xehen është dashur transportuar së pari me kafshë ngarkimi, mandej me qerre kafshësh dhe kësisoji të sillej deri te rrugët nëpër lugina, prej nga

mund ta merrnin kamionat. Për këtë qëllim Südost-Montanit nga ana e armatës i janë vënë në dispozicion 100 kafshë të ngarkimit (mushka e kuaj) prej rekuizimit italian. Furnizimi me ushqim bagëtish iu vu për detyrë udhëheqësit ushtarak ekonomik të armatës së dytë të blinduar.³⁵

Për sigurimin e fuqisë punëtore gjithashtu që ngarkuar Südost-Montani me një premtim se do t'i siguroheshin italianët e zënë robër. Për të pajisur punëtorët me vegla të nevojshme, prej magazinave në Tiranë e Durrës u hodhën 400 ton material dhe vegla të rekuizuara prej kompanisë italiane AMMI. Pajisjen dhe veglat për kompaninë e batalonit 26 teknik, i siguronte Shtabi kryesor i trupave teknike. Mbikëqyrjen e afarizmit të gjithmbarshëm e bënte i autorizuari i përgjithshëm për miniera të xeheve të metalit për Juglindje, përmes të të autorizuarit të vet në Shqipëri. Lidhur me punët e drejtpërdrejta në miniera dhe për transportimin e xehes u themeluan dy drejtori: një në Kukës dhe një në Gjakovë.³⁶

Të gjitha organet kompetente civile dhe ushtarake që ishin të angazhuara në eksploatimin e minierave të kromit në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni, hartuan një plan të realizueshëm të prodhimit dhe të dërgimit në Gjermani të xehes së rishprodhuar dhe të asaj që gjendej në depo. Sipas këtij plani, më datë 1 tetor të vitit 1943 në depo të minierave dhe në stacionet hekurudhore u gjeten këto sasi xeheje kromi, që duheshin dërguar në Gjermani:

1. Sasitë e gjetura të xehes së mihur në deponitë e minierave të Kosovës e Shqipërisë

Miniera	Xehe përmb. 40% Cr ₂ O ₃ ton.	Xehe përmb. 30% Cr ₂ O ₃ ton.	Xehe përmb. 20% Cr ₂ O ₃ ton.	Gjithsej xehe ton
Gjakova	4.500	300	—	4.800
— Letaj				
Kukës	7.100	1.000	—	8.100
Klos	4.000	—	—	4.000
Pogradec	1.800	—	—	1.800
Rahovec	—	300	—	300
Gjithsej ton	17.400	1.600	—	19.000

Kjo xehe përmbante gjithsej 7.480 ton Cr₂O₃, ose 5.000 ton metal të pastër krom.

³⁵ NAW, T 77, R 1300, f. nr. 1307 dhe 1311

³⁶ Njësoj, f. nr. 1307.

2. Xehja e gjetur në deponitë e stacioneve hekurudhore

1. Në stacionin hekurudhor të Strugës	1.700 ton
2. Në stacionin hekurudhor të Pejës	850 „
3. Në stacionin hekurudhor të Lipjanit	750 „
4. Në portin e Durrësit	300 „
Gjithsej xehe	3.600 ton

Kjo xehe përmbante gjithsej 1.500 ton Cr_2O_3 , ose 1.000 ton krom-metal të pastër.

Duke llogaritur së bashku edhe rezervat e gjetura në deponitë e minierave edhe ato në stacionet hekurudhore, gjithsej janë gjetur 22.600 ton xehe përmbajtjeje 40% dhe 30% Cr_2O_3 , me përmbajtje të gjithmbarshme prej 6.000 ton metal-kromi të pastër.³⁷

Si sasi të mundshme të prodhimit në vitin 1944, janë paraparë.

Miniera	Xehe përmb. 40% Cr_2O_3	Xehe përmb. 30% Cr_2O_3	Xehe përmb. 20% Cr_2O_3	Gjithsej në ton
Gjakovë				
— Letaj	20.000	3.000	2.000	25.000
Kukës	6.000	3.000	3.000	12.000
Klos	10.000	—	2.000	12.000
Pogradec	8.000	2.000	2.000	12.000
Rahovec	—	1.000	5.000	5.000
Gjithsej:	44.000	9.000	14.000	67.000

Në këtë xehe përmbaheshin 20.300 ton Cr_2O_3 , respektivisht 13.804 ton metal-kromi të pastër.

Kjo sasi metali të pastër në xehen përmbajtjeje mbi 30% Cr_2O_3 , zmadhohej për 2.800 ton koncentratit të përqindjes 50%, që do të merrej me flotacionin e xehes së një përmbajtjeje të varfër nën 20% Cr_2O_3 në flotacionin të Shkupi. Me këtë mënyrë fitohej një sasi prej 15.204 ton krom-metal të pastër. Kjo është një sasi shumë e shënueshme në krahasim me përmbajtjen e vlerësuar të metalit në xehen e fituar në territorin e mbarë Evropës juglindore prej 54.427 ton. Kjo do të thotë se prodhimi i

³⁷ NAW, T 77, R 1300, f. nr. 1334-1337.

xeheroreve të Kosovës dhe të Shqipërisë do të jipte më se një të katërtën (27,9%) e prodhimit të gjithmbarshëm të kromit në Juglindje.³⁸

Prodhimi vetëm i xehes më të pasur është paraparë për çdonjërin muaj si pason:

Muaji	Gjakovë-Letaj dhe Kukës		Klos, Pogredec dhe Rahovec		Gjithsej	
	30%	40%	30%	40%	30%	40%
Janar	500	1.000	—	—	500	1.000
Shkurt	500	1.000	—	—	500	1.000
Mars	500	1.000	—	1.800	500	2.800
Prill	500	1.000	—	1.800	500	2.800
Maj	500	2.500	—	1.800	500	4.300
Qershor	500	2.500	—	1.800	500	4.300
Korrik	500	2.500	500	1.800	1.000	4.300
Gusht	500	2.500	500	1.800	1.000	4.300
Shtator	500	3.000	500	1.800	1.000	4.800
Tetor	500	3.000	500	1.800	1.000	4.800
Nëntor	500	3.000	500	1.800	1.000	4.800
Dhjetor	500	3.000	500	1.800	1.000	4.800
Gjithsejt:	6.000	26.000	3.000	18.000	9.000	44.000

Prodhimi prej rreth 50.000 ton krom-metali në vit ka qenë detyrë e përhershme e organeve kompetente gjermane në Juglindje, pasi kjo ishte kusht i domosdoshëm për prodhimin gjerman të luftës, pra edhe për vlerën luftarake të armatës gjermane, posedimi i minierave në Kosovë e Shqipëri, lehtësonte këtë detyrë. Mirëpo, të gjitha këto organe ishin të vetëdijshme se realizimi i prodhimit të mundshëm të paraparë ngërthente në vetvete një gjendje pasigurie (pezullie) për shkak të aksioneve të përhershme të forcave të ushtrive nacionalçlirimtare të Shqipërisë dhe të Jugosllavisë, të cilat pengonin prodhimin dhe transportimin e xehes për në Gjermani. Tanimë është thënë se minierat në trollin rreth Pogradecit gjendeshin në duar të UNÇ të Shqipërisë, dhe në kalkulimet e prodhimit për vitin 1944, ato nuk merreshin në konsiderim deri në muajin mars siç u pa nga tabela e sipërme. Veç kësaj, edhe lokacioni i minierave në terrenin e Gjakovës e të Kukësit ishte i atillë, sa që sigurimi i tyre prej sulmeve të forcave nacionalçlirimtare ishte fort i vështirësuar.

Detyrë e parë e kompanisë xehetare (minatore) të batalonit 26 teknik, që nisi të punojë në minierat të Gjakova e Kukësi në tetor të vitit

³⁸Njësoj. Për të pasur pasqyrën e vërtet të pjesëmarrjes së planifikuar në prodhimin e minierave nga territori i Kosovës dhe i Shqipërisë në mbarë prodhimin në Juglindje të Evropës, shih tabelat 1 e 2.

1943, ishte të siguronte dërgimin e rezervave të xehes së mihur prej rreth 14.000 ton. Mirëpo, për shkak të gjendjes së rrugëve, ka mundur vetëm një pjesë e vogël e kësaj xeheje të transportohej drejtpërdrejt me kamionë deri në stacionin hekurudhor në Pejë. Pjesa më e madhe doemos duhej bartur me kafshë ngarkimi dhe qerre qysh prej puseve të largëta, deri në terrenet e ulta, ku mund të arrinin kamionët. Pranë disa puseve në kohën e eksploatimit italian ekzistonin teleferikë të vegjël me të cilët xehja prej puseve zbritej në lugina, porse këta teleferikë partizanët i kishin çaftësuar. Ata gjithashtu kishin shkatërruar objektet për strehimin e personelit e të pajisjes dhe kishin marrë me vete të gjitha rezervat ekzistuese të artikujve të konsumit dhe të pajisjeve. Këto aksione ndikonin shumë në zvogëlimin e sasive të marra të këtij materiali shumë të rëndësishëm strategjik për makinerinë gjermane të luftës (luftarake).

Pas sjelljes së pajisjes teknike prej Durrësi e Tirane, kompanisë teknike gjermane i shkoi për dore që disa nga teleferikët e vegjël t'i aftësojë për punë. Kështu që pos përdorimit të kafshëve të ngarkimit, filloi transporti edhe përmes teleferikëve e sasive të gjetura të xehes në deponitë, deri në rrugët e afrueshme në lugina.

Kompania italiane AMMI minierat e xehes së kromit në Shqipëri e Kosovë i shfrytëzonte si reparte sezonale. Për shkak të trolit të vështirë dhe të mosndërtimit të rrugëve të afrimit, furnizimi i punishteve (kantierëve) dhe bartja e xehes së mihur gjatë dimrit ishin shumë të vështirësuar, kështu që në këtë sezon puna pushonte dhe punëtorët shpërndaheshin nëpër shtëpitë e tyre. Për shkak të një organizimi të këllë të prodhimit, pranë minierave nuk ekzistonin ndërtesa të përshtatshme për strehimin e punëtorëve dhe të personelit tjetër gjatë dimrit. Mirëpo, nevojat gjermane për krom ishin shumë më të mëdha se ato italiane, dhe u planifikua që prodhimi dhe dërgimi i xehes të vazhdojë edhe gjatë gjithë dimrit dhe të vihen në veprim të gjitha forcat në disponim që prodhimi të shtohet dukshëm.³⁹

Në muajt tetor e nëntor të vitit 1943 punohej në aftësimin e objekteve të rrënuara dhe në ndërtimin e një ndërtese për strehimin dimëror të punëtorëve, të njësiteve për sigurimin e minierës dhe të personelit tjetër, si dhe i magazinave për ruajtjen e artikujve ushqimorë dhe të pajisjeve dhe i punëtorëve për mirëmbajtjen e reparteve. Vazhdoi transportimi i pajisjeve për teleferikë, që u gjet në depot e Tiranës e të Durrësit dhe në depo të tjera të njërive ushtarake të inxhinjerisë në Shqipëri, si dhe aftësimi i teleferikëve për hudhjen (bartjen) e xehes prej puseve deri te rrugët afruese në lugina. Deri kah mesi i muajit nëntor këta teleferikë të vegjël u meremetuan dhe u vunë në shfrytëzim. Njëkohësisht në zonën e minierave punohej edhe në meremetimin e rrugëve të vjetra dhe në ndërtimin e të reja. Në territorin e të dy drejtorive (të Kukësit e të

³⁹ NAW, T 77, R 13000, f. nr. 1331. Raporti i Kisovit dt. 15. XI. 1943.

Gjakovës), u meremetuan ose ndërtuan 3,8 km rrugë, kurse në 3 km të tjerë punimet ishin kryer deri në vënien e shtresës së sipërme.

Deri në fund të tetorit të vitit 1943, u prodhuan sasi të e para prej gjithsejt 350 tonë xehe. Njëkohësisht prej stacionit hekurudhor të Pejës u dërguan në Gjermani 2.500 tonë xehe. Në nëntor prodhimi arriti në 420 tonë, kurse dërgimi në Gjermani në 1.540 tonë.⁴⁰

Në muajin dhjetor të vitit 1943 qenë kryer ndërtesat për strehimin e punëtorëve, punëtoritë, garazhat dhe objekte të ngjashme. Nga fundi i muajit dhjetor, disa ditë binte borë dhe kjo shkaktoi ndërprerjen e prodhimit, sepse punëtorët përdorëshin për pastrimin e borës në rrugë dhe rreth objekteve të minierave. Përpos shkakut të borës, transportimi i xehes nga minierat deri te stacioni hekurudhor në Pejë qe vështirësuar edhe për mungesë karburanti, pjesësh ndërrimi dhe gomash për kamione me të cilët kryhej transportimi i xehes. Për mungesë të dizelkarburantit dhe të benzinës, kamionet ripunoheshin dhe ktheheshin në lëvizje me gaz druri, por rezultatet qenë të dobëta, sepse kamionet për shkak të amortizimit dhe të rrugëve të këqia gjithnjë e më shumë nxirreshin jashtë përdorimit. Së këndejmi Berlioni dhe Ministria e aviacionit (RLM — Reichsluftfahrtministerium) me urgjencë dërgoi gjashtë kamionë tonazhi të mesëm. Këta kamionë u kyçën në transport më 27 janar të vitit 1944, por edhe këta ishin vjetëruar dhe pas shtatë ditësh vetëm një ishte në gjendje vozitjeje. Transportimi i xehes qe vështirësuar edhe për shkak të futjes së kuajve ngarkues në karantinë nga shkak i dyshimit për sëmundjen e sakagjisë. Rezultat pune në muajin dhjetor ishte prodhimi i 800 tonë xehe dhe dërgimi i 1.100 tonë prej stacionit hekurudhor të Pejës. Pos kësaj, prej Struge deri në Manastir janë transportuar 350 tonë xehe nga rezervat e gjetura ditën e kapitulimit të Italisë.⁴¹

Për sigurimin e këtyre minierave në muajin tetor qe angazhuar një kompani e feldgjindarmërisë gjermane. Pasi kjo u tregua e pamjaftueshme për shkak të shfaqjes dhe të aksioneve të fshehta të njësiteve partizane, në muajin nëntor, veç feldgjindarmërisë gjermane, u angazhua edhe milicia shqiptare. Mirëpo, u tregua se njerëzit e milicisë nuk ishin të „besueshëm”. Gjermanët kishin konstatuar se ka pasur anëtarë milicie që mbanin kontakte me partizanë. Prandaj, u soll kompania 6 e batalionit „Kroatien” (Wi Sicherungs-Batalion Kroatien) për sigurimin e objekteve ekonomike.⁴²

Për të mënjeluar vështirësitë e mëdha për shkak të kamionëve të vjetëruar, për të cilët s’mund të gjendeshin pjesë ndërrimi, sidomos për kamionet e zënë (rekuzuar) italianë, në janar armata vuri në dispozicion kamionët e saj për transportimin e xehes prej puseve deri te stacionet hekurudhore të ngarkimit. Kjo bëri të mundur që të transportohen deri në stacionin hekurudhor të Pejës dhe të ngarkohen në vagonë 1.032 tonë,

⁴⁰ NAW, T 77, R 1300, f. nr. 1331 dhe 1352, Raporti i Kisovit për gjendjen në Shqipëri dt. 15. XI dhe 18. XII. 1943.

⁴¹ NAW, T 77, R 1299, f. nr. 33 dhe 67, Raporti i Kisovit mbi gjendjen në Shqipëri, dt. 15. I. dhe 19. II 1944.

⁴² NAW, T 77, R 1300, f. nr. 1352, Raporti i Kisovit mbi gjendjen në Shqipëri dt. 18. 12. 1943.

kurse prej deponisë së Strugës me kamiona të armatës u transportuan në Bitol (Manastir) 1.000 tonë dhe pos këtyre edhe 165 tonë me hekurudhën e binarit të ngushtë përmes Tetovës deri në Shkup. Angazhimi i kamionëve të armatës bënte të mundur që transporti i xehes prej deponive të minierave deri te stacionet hekurudhore të rritet në 5.000 deri në 6.000 tonë në muaj. Prodhimi xehes së re në janar të vitit 1944 bënte 1.305 tonë.⁴³

Gjatë tërë muajit janar të vitit 1944 s'pranin sulmet e njësiteve partizane kundër minierave në rrethinat e Gjakovës e të Kukësit. Kështu, ato më 31 janar sulmuan dhe shkatërruan stacionin nisës të teleferikut Kam-Kepenik.⁴⁴ Me këtë u ndërpre transportimi i mëtejshëm i xehes, por kjo përkohësisht nuk preku transportin e tërësishëm të xehës, nga se xehja në deponinë e stacionit nisës tashmë ishte hudhur (bartur) në luginë, prej nga me kamionë transportohej deri në stacionin hekurudhor në Pejë. Këtë aksion të partizanëve gjermanët e morën si një provë të re të pabesnikërisë së milicisë shqiptare, e cila duhej të mbronte këto reparte. Së këndejmi, që kërkuar që kompania 6 e batalonit „Kroatien” të përforcohet me njerëz të ri, sepse numri i saj s'ishte i mjaftë të kryej detyrat e sigurimit në mbarë zonën e minierave në rrethinën e Kukësit dhe të asaj të Gjakovës.⁴⁵

Në shkurt të vitit 1944 minierat e këtij rajoni dhe rrugët në drejtim të Gjakovës dhe Pejës ishin gjithnjë të rrezikuara prej aksioneve të dendura të forcave nacionalçlirimtare. Më 31 janar partizanët shkatërruan stacionin nisës të teleferikut Kam-Kepenik. Për të siguruar prodhimin dhe transportin, në gjysmën e dytë të muajit shkurt komanda gjermane ndërmoi aksione ushtarake ofansive në territorin e minierave dhe në rrethinën e afërt. Ky operacion mori emërtimin „Pik”. Filloi më 13 shkurt të vitit 1944. Në ditarin e vet të luftës, udhëheqësi ushtarak i ekonomisë Kisov, për këtë operacion ka shënuar se qëllimi i tij është shkatërrimi i njësiteve nacionalçlirimtare të Shqipërisë që gjendeshin në veriperëndim të Kukësit, për të: „a) mënjanuar kërcënimin ndaj viseve të xehes së kromit në perëndim të Gjakovës dhe në jug të Kukësit dhe siguruar shfrytëzimin e plotë të kësaj treve xeherore;” „ b) të bëhet i pamundshëm rrezikimi i rrugës për transport (V).” Për të kryer me sukses operacionin „Pik”, udhëheqësi ekonomik-ushtarak Kisov-i, njësiteve operative që morën pjesë në aksion, ua caktoi edhe batalonin 6 për sigurimin e objekteve ekonomike, që ishte i angazhuar në sigurimin e puseve të ndryshme të minierave të këtij rajoni.⁴⁶

Në raportin e udhëheqësit ushtarak ekonomik Kisovit për muajin shkurt, konstatohet se me operacionin „Pik” ishte mënjanuar vetëm reziku i drejtpërdrejtë prej sulmeve të forcave të Ushtrisë nacionalçlirimtare kundër minierave dhe rrugëve për transport. Qysh në muajin e ardhshëm, këto sërish ndërmorën aksione ofansive.

⁴³ NAW, T 77, R 1300, f. nr. 1352, Raporti i Kisovit për gjendjen në Shqipëri dt. 19. II. 1944.

⁴⁴ Njësoj.

⁴⁵ Si vërejtja 43.

⁴⁶ NAW, T 77, R 1299, f. nr. 11. Ditari i luftës i Kisovit.

Gjatë shkurtit të vitit 1944, prodhimi i xehes u rrit në 1.874 tonë por dërgimi në Gjermani u zvogëluar në gjithsej 682,5 tonë. Prodhimi i shtuar ndikonte në rritjen e sasisë së xehes që gjendej në deponitë pranë puseve xehetare. Kjo xehe më datën 29 shkurt bënte 13.972 tonë. Pas kësaj, ka pasur edhe 1.678 tonë xehe në „ndërdeponitë”, që u formuan në pjesët e ulta të terrenit në rajonin e minierave, prej nga mund të ngarkohej në kamionë dhe të transportohej më tutje.⁴⁷

Një rritje më e ndieshme e prodhimit të xehes u arritë në muajin mars të vitit 1944, kur u nxorën 3.282 tonë xehe, që do të thotë dy herë më tepër se sasia që ishte parashikuar me planin e hartuar në muajin tetor të vitit 1943.⁴⁸ Kjo erdhi për shkak të pamundësisë që të fillohet me eksploatimin e minierave në perëndim të Liqenit të Ohrit, të cilat ende gjendeshin nën kontrollin e forcave të Ushtrisë nacionalçlirimtare, kështu që përpjekjet për shfrytëzimin e minierave në rajonin Gjakovë — Kukës, u dyfishuan.

Mirëpo, transportimi i xehes së mihur nuk mundi të përcjellë (ndjekë) prodhimin e rritur. Në Vagonë të hekurudhës u ngarkuan gjithsej 1.642.5 tonë xehe. Prej tyre 622 tonë u ngarkuan në stacionin hekurudhor të Ferizajit. Këtë sasi xeheje e transportuan kamionët ushtarakë, të cilët prej këtij stacioni hekurudhor merrnin materialin për furnizimin e trupave gjermane në Shqipëri. Mirëpo, edhe përkundër kësaj ndihme në transport nga ana e kamionëve ushtarakë, sasia e xehes në deponitë pranë puseve dhe në ndërdeponitë nuk u zvogëluar, dhe më 31. III. 1944 bënte 12.877, respektivisht 2.502 tonë që gjithsej bëjnë 15.379 tonë. Për të mirësuar mundësitë e transportimit, kompania teknike xehetare në bashkëpunim me të autorizuarin e përgjithshëm për minierat e xeheve të materialit në Juglindje, organizoi dy punëtori për mirëmbajtjen dhe riparimin e kamionëve. Gjatë marsit në to u krye riparimi gjeneral i nëntë kamionëve, përpos mirëmbajtjes së automjeteve të tjera.⁴⁹

Në muajin prill masat e ndërmarra për aftësimin e parkut të automjeteve dhe për ndihmën e kamionëve ushtarakë, ndihmuan të transportohet një sasi më e madhe e xehes deri në stacionet hekurudhore në Pejë e Ferizaj. U ngarkuan dhe u dërguan për Gjermani gjithsej 3.153 tonë xehe, prej të cilave kamionët ushtarakë transportuan deri në stacionin e Ferizajit 1.462 tonë kurse sasia tjetër ka shkuar përmes Pejës. Edhe përkundër shtimit të dërgimit, rezervat e xehes në deponitë pranë puseve xeherore dhe në ndëreponi, u rrit në 16.682 tonë sepse edhe prodhimi në prill u shtua dhe arriti në 4.358 tonë përkatësisht ishte më i madh se sasia që u liferua.⁵⁰

Nga fundi i prillit të vitit 1944 ishte krejt e sigurtë se nuk mund të llogaritej më me liferimin e xehes së kromit prej Turqisë, e cila më 20 prill hoqi dorë prej liferimit të mëtejme. Kjo gjë ndikoi që prodhimi në vendet

⁴⁷ NAW, T 77, R. 1299, f. nr. 76-77, Raporti i Kisovit për gjendjen në Shqipëri dt. 16. III. 1944.

⁴⁸ Shih tabelën IV.

⁴⁹ NAW, T 77, R 1299, f. nr. 124, Raporti i Kisovit mbi gjendjen në Shqipëri dt. 17. IV. 1944.

⁵⁰ Njësoj, f. nr. 153, Raporti i Kisovit për gjendjen në Shqipëri, dt. 18. V. 1944.

ballkanike nën pushtimin gjerman të marrë rëndësi edhe më të madhe. Hitleri personalisht dha urdhër që me të gjitha mjetet, pa marrë parasysh vështirësitë, të intensifikohet eksploatimi i xeheve të kromit në Shqipëri e Maqedoni. Edhe i autorizuari special për Juglindje Nojbaheri dhe komandanti i grupit „F” të armatave, mënjëherë u dhanë urdhër organeve vartëse të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë për shtimin e prodhimit deri në kufijt e mundshëm ekstremë.⁵¹

Duke u nisur prej rezultateve të arritura gjatë muajit mars dhe prill, u vlerësua se në rajonin e Gjakovës prodhimi mujor mund të rritet në 3.500 deri në 4.000 tonë kurse në rajonin e Kukësit në 2.000 deri në 2.500 tonë respektivisht gjithsej në 5.500 deri në 6.500 tonë. Qysh në muajin maj kjo u tregua e mundshme, sepse prodhimi u rrit në 5.198 tonë. Mirëpo, kjo sollë rritjen edhe më të madhe të xeheve në deponitë, ku gjenëdeshin 19.356 tonë.

Meqë prodhimi i shtuar s'mund të transportohej me kamionët e disponueshëm, drejtorive në Gjakovë e Kukës iu caktuan dy kompani transporti si Njësite speciale të transportit në Juglindje (Transportsonderkommando Südost) me 194 kamionë tonazhi të përgjithshëm prej 420 tonë.

Pos dërgimit të dy kompanive të transportit, u mor vendim për fillimin e punimeve në ndërtimin e hekurudhës së binarëve të ngushtë prej Gjakovës deri në Pejë dhe në vënien e një binari special për ngarkimin e xeheve të kromit në stacionin hekurudhor në Ferizaj, ku me ngarkim kishte vështirësi, sepse përmes këtij stacioni të kapacitetit të vogël shkonte furnizimi i trupave gjermanë në Shqipëri. U shpejtuan edhe punimet në meremetimin e rrugëve, sidomos të asaj Gjakovë — Pejë.⁵²

Gjatë muajit prill dhe maj të vitit 1944 u intensifikuan përpjekjet e forcave nacionalçlirimtare në trevën e minierave të kromit në rajonin e Gjakovës. Qëllimi i këtyre sulmeve ishte të vështirësohet prodhimi dhe transportimi i xeheve të kromit. Në maj u bë një sulm kundër minierës Zogaj. Në këtë terren njëkohësisht u shpërndanë trakte në gjuhën serbokroate, me të cilat ftohej popullsia të sabotojë prodhimin dhe transportimin e xeheve në Gjermani, sepse kjo do të thoshte dobësim të përgjithshëm të potencialit gjerman të luftës.

Gjermanët me të gjitha mjetet orvateshin ta ruajnë e ta rrisin prodhimin e xeheve pa të cilën nuk bënte. Së këndejmi përforcuan forcat për sigurimin e minierave prej sulmeve të forcave çlirimtare. Që paraparë që për këtë qëllim të sillnin njësitët vullnetare të përbëra prej kuislingësh nga Kaukazi. Meqë kjo gjë u tregua si e pasendërtueshme, u vendosë që prej forcave të stacionuara në Gjermani të ndahet e të dërgohet në Gjakovë një repart prej 20 ushtarësh. Ky numër flet qartë se në Gjermani resurset njerëzore ishin shterrur. Andej, ata bënin përpjekje gjithnjë e më të mëdha të gjenin kuislingë që do t'i përdornin për ruajtjen e kontrollit në territoret e

⁵¹ NAW, njësoj, f. nr. 103, 105, Ditari i luftës i Kisovit.

⁵² NAW, njësoj, f. nr. 196-197, Raporti i Kisovit mbi gjendjen në Shqipëri, dt. 15. VI. 1944.

pushtuara. Kështu, shpresat për përmirësimin e pozitës në rajonin e minierave të kromit u bështetën në divizionin e rishformuar SS „Skenderbeu”. Shtabi i Korparmatës alpiniste XXI, më 1 maj 1944 këtë divizionin i transmetoi obligimin për sigurimin e zonës së minierave. Divizionit SS „Skendërbeu” ishte i nënshtruar bataloni 6 ushtarako-ekonomik për sigurim, njësitet e të cilit qysh më parë gjendeshin në këtë terren. Në marrëveshje me udhëheqësin ushtarak ekonomik Kisovin, sigurimi u organizua asisoji që një kompani e divizionit SS „Skenderbeu” u caktua në trevën e drejtorisë xehetare të Gjakovës, kurse bataloni 6 ushtarak-ekonomik i sigurimit u caktua në territorin e Drejtorisë xehetare të Kukësit. Nga fundi i muajit korrit të vitit 1944 në territorin e të dy drejtorive xehetare u sollën edhe 60 turkmenë që u vunë nën komandën e njësiteve tanimë të përmendura.⁵³

Nga fundi i majit të vitit 1944, në Gjakovë u bë një racë (arrestim masiv) kundër komunistëve dhe bashkëpunëtorëve të tjerë të Lëvizjes nacionalçlirimtare — „elementë të padëshiruar”. Shumë njerëz qenë burgosur. Ky aksion me gjasë u ndërmor në kuadrin e përpjekjeve të përgjithshme që të „qetësohet” ky rajon dhe të sigurohet prodhimi i papenguar dhe dërgimi i xehes së kromit në Gjermani. Mirëpo, edhe përkundër të gjitha këtyre masave të gjermanëve e të kuislingëve, aksionet e forcave nacionalçlirimtare të Shqipërisë e të Jugosllavisë, që operonin në territorin e Kosovës dhe të Shqipërisë së veriut, nuk dobësoheshin. Në rrugët me të cilat kryhej transportimi i xehes me kamionë prej minierave deri te stacioni hekurudhor në Pejë e Ferizaj, partizanët vënin mina të vogla që mjaftonin për të çaftësuar kamionin për vozitje,⁵⁴ por bëheshin edhe sulme të drejtpërdrejta mbi kamionë. Gjatë qershorit të vitit 1944 nga këto aksione u nxorrën jashtë përdorimit 29 kamionë dhe tri automjete të lehta. Prej dekadës së fundit të muajit qershor, u intensifikuan edhe sulmet e aeroplanëve anglezë me fluturim të ulët, që mitralonin kolonat e kamioneve të cilët transportonin xehe ose material për furnizimin e trupave gjermanë në Shqipëri. Shihej qartë se aksionet e intensifikuara të forcave nacionalçlirimtare dhe ato të aviacionit anglez kundër kolonave të kamionëve, ishin të koordinuara dhe kishin të njëjtin qëllim — pengimin e furnizimit të industrisë gjermane të luftës me këtë lëndë të parë të rëndësishme.⁵⁵

Megjithëse organet kompetente gjermane civile e ushtarake, qysh në ditët e para pas kapitulimit të Italisë dhe të formimit të Komitetit ekzekutiv në Tiranë, kishin shtruar çështjen e rregullimit të marrëdhënieve në lëmin e xehetarisë, ana juridike e eksploatimit gjerman të minierave të kromit, deri në pranverë të vitit 1944, ende s’ishte zgjidhur. I besuari për minierat e xehes së

⁵³ NAW, njësoj, f. nr. 104, 106, 153, 196.

⁵⁴ E mjaftueshme ishte, për shembull, të mbetet kamioni pa gomë dhe të nxirret prej përdorimit, sepse mbretëronte mungesë e madhe e gomave automobilistike.

⁵⁵ NAW, T 77, R 1299, f. nr. 249-250, Raporti i Kisovit mbi gjendjen në Shqipëri, dt. 21. VIII. 1944. Për të vështirësuar liferimin e xehes së kromit në Gjermani, aviacioni aleat në muajin gusht bombardoi Pejën, ku gjendej stacioni ngarkues për transportimin e xehes, sikurse ka vepruar edhe me nyjet hekurudhore në Shkup e Nish.

metaleve, këshilltari i lartë ushtarak-administrativ, gjenerali Krone,⁵⁶ nga fundi i muajit maj të vitit 1944 i shkruante drejtorit të përgjithshëm Salzdetfurth-Konzernit, Shtalit (Rudolf Stahl), se negociatat e deriatëhershme me qeverinë shqiptare për rregullimin e bazës juridike të marrjes së të drejtave xeherore dhe të pronësisë së kompanisë italiane AMMI, kanë mbetur pa rezultate, sepse qeveria shqiptare donte për këtë të përfundohet një marrëveshje midis saj dhe qeverisë gjermane, të ngjashme me marrëveshjen që u pat përfunduar me kohë midis qeverive gjermane dhe bullgare për shfrytëzimin e minierave në zonën e pushtimit bullgar të Jugosllavisë (Marrëveshja e Klodiusit). Pra, jo marrëveshje me Südost-Montanin, si donte Gjermania. Kjo marrëveshje mandje, do t'u përkiste jo vetëm minierave të kromit, që Gjermaninë e interesonin më së shumti, por edhe minierave të magnezitit, disa minierave të plumbit e zinkut, të antimonit e tj., që në atë kohë nuk punonin.⁵⁷ Për këtë Krone shkruante:

„Shqiptarët s'tregojnë ndonjë interes të madh për përfundimin imediat të një marrëveshjeje, sepse duan së pari ta shohin mbarimin e luftës. Për ne tani është gjëja kryesore të nxjerrim sa të jetë e mundur më shumë xehe (kromi Zh. A.) dhe ta dërgojmë në Gjermani. Gjurmimi dhe eksploatimi i minierave të reja në vitin e pestë të luftës s'janë të mundshme për mungesë të njerëzve e të materialit, çka paraqet vështirësi edhe për repartet që funksionojnë”.⁵⁸

Në përgjegjen dërguar Kroneut, drejtori i përgjithshëm Rudolf Stali qorton aleatët gjermanë të Ballkanit pse përherë kërkojnë „traktate solemne shtetërore që thjeshtë të ndihmojnë”. Në vazhdim ai shkruan se gjermanët s'kanë vepruar mirë në fillim të luftës „kur shtete të ndryshme atje poshtë kemi furnizuar me suverenitet në dukje dhe pos kësaj kemi krijuar aso institucione, të papërshtatshme për udhëheqje qendrore ekonomike, sikundër janë protektorati ose guvernmani i përgjithshëm”.⁵⁹

⁵⁶ Organizimi i prodhimit xehtar në Evropën juglindore ishte kësisoji: në krye gjendej I autorizuar i përgjithshëm për ekonomi në Serbi, konsulli gjeneral Franc Nojhauzeni. Në vartësinë e tij të drejtpërdrejt gjendej i autorizuar i përgjithshëm për minierat e xeheve të metali për Maqedoni ishte Dürriqel, e për Shqipëri — Krone. (Vereinigte Deutsche Betriebsarchiv der Kaliindustrie, Stassfurt, NDR (në tekstin e mëtuftjeshëm: VDBA), fondi A II, SA, la, Bor, fasc. nr. 11, fleta nr. 211, letra e Kroneut dërguar Shtalit më 29. V. 1944).

⁵⁷ Pos minierave të xeheve të kromit në Shqipëri, gjermanët eksploatonin edhe minierën e thëngjillit në Krrabë, prej nga furnizoheshin trupat gjermane me qymyr. Në pjesën e Kosovës së inkuadruar në përbërjen e „Shqipërisë së Madhe”, eksploatonin edhe minierën e magnezitit „Golesh”. Ky prodhim ishte i vogël nga se pajisja për nxjerrjen e xeheve ishte e vjetruar dhe e amortizuar. Për transportimin e kësaj xehe deri në stacionin hekurudhor në Lipjan, xeherorja ka pasur dy kamionë me grahje me gaz të drunjt. S'kishte as mjaft qymyr për zhuritjen e xeheve, kështu dërgohej në Gjermani në gjendje të njomë (të papërpunuar), çka paraqiste barrë për komunikacionin edhe ashtu të mbingarkuar hekurudhor. (Naw, T 77, R 1299, f. nr. 113, Ditari i luftës i Kisovit dhe raporti i tij mbi vizitën e bërë minierave, dt. 18. VI. 1944).

⁵⁸ VDBA, Shtasfurt, si në vërejtjen 56. Deri në luftë, Krone ishte njëri nga drejtorët e kompanisë Mansfeldsche Kupferschieferbegbau AG prej Ajslebeni. Kjo kompani ka qenë e inkuadruar në përbërjen Slazdetfurt-Konzernit. Edhe pas dërgimit në Ballkan me detyrë ushtarake, Krone vazhdoi të mbajë lidhje me drejtorin gjeneral të Konzernit, Rudolf Shtalin, të cilin e informonte mbi gjendjen në Ballkan dhe mbi vendxehet që janë interesante për Konzernin edhe pas lufte. Konzerni bënte përpjekje të mëdha që në Ballkan të ketë sa më shumë njerëz të tij dhe përmes tyre, si dhe përmes personaliteteve kompetente në Ministrinë e ekonomisë dhe në atë të financave, të vejë dorë mbi pasurinë xeherore të vendeve ballkanike, sikurse kishte vepruar tashmë me Borin dhe bënte përgatitje për vetësimin e Trepçës. Hans Radant-i shkruan se Krone, deri sa ka qenë në Ajsleben, ka qenë i akuzuar për kontraband në bursën e zezë, kështu që shumë minatorë të kompanisë Mansfeld AG, që ishin të inkuadruar në batalonin minator „Juglindja”, ishin të befasisur kur në Ballkan e panë me gradën e gjeneralit. (Radant, Hans, Kriegsverbrecherkonzern Mansfeld. Die Rolle des Mansfeld-Konzerns bei der Vorbereitung und wärend des zweiten Welt kriegs, Berlin 1964, 224).

⁵⁹ VDBA, A II, Sa, L, a, Bor, fasc. nr. 11, fleta nr. 233. Letra e Shtalit dërguar Kroneut, Berlin, 27. VI. 1944.

Meqë zhdrivillimi i luftës në Ballkan me shpejtim po i afrohej fundit, baza juridike e eksploatimit të minierave në Kosovë e Shqipëri s'ishte rregulluar as me qeverinë kuislinge shqiptare, e cila në realitet s'ka pasur kurrfarë të drejte të lidhë traktate fuqiplote shtetërore, që do t'i përkisnin edhe territorit të anektuar kësaj, me vullnetin e njëanshëm të ngadhënjimtarëve të përkohshëm, anektim të cilin pala e dëmtuar dhe i tërë koalicioni antihitlerian kurrnjëherë s'e kishte njohur.

Kjo gjë Gjermaninë s'e pengonte fare. Siç shkruante gjenerali Krone, për të ishte e rëndësishme të nxirrte sa më tepër sasi të këtij metali të domosdoshëm, vendzbulimet e të cilit në Maqedoni, në Kosovë e në Shqipëri u bënë bazë e furnizimit të industrisë gjermane pas ndërprerjes së importit prej Turqisë. Së këndejmi, gjermanët gjatë muajve qershor e korrik bënë përpjekje ekstreme të shtojnë prodhimin e të sigurojnë transportimin e xehes për në Gjermani. Nga fillimi i qershorit një grup special transportues në përbërje të dy kompanive transporti, nën komandën e majorit Brenner (Brenner), arriti në Kosovë. Njëra kompani që vendosur në Pejë dhe tjetra bashkë me komandën e mbarë grupit, në Prizren. Këta kamionë u kyçën në transportin e xehes më 14 maj të vitit 1944. Me këtë, kapaciteti i transportit të xehes prej ndërdeponive në zonën e minierave deri të stacionet hekurudhor në Pejë e Ferizaj, u rrit dukshëm. Me vetë këtë fakt, u krijuan kushte edhe për një prodhim më të madh të xehes. Së këndejmi, prej deponive në Shqipëri u hodh i tërë materiali teknik i nevojshëm për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e teleferikëve të vegjël prej puseve deri në rrugët afruese nëpër lugina, kjo kishte rëndësi të madhe për shtimin e dërgesave, sepse shumica dërmuese e xehes së paeksportuar rrinte në deponitë pranë puseve të minierave. Pos kësaj, në depon Sasso Bianca në Italinë veriore, u siguruan 41 vagoneta dhe 7 kompresorë të destinuar për minierat e kromit në Kosovë e Shqipëri.⁶⁰ Komandanti i Juglidnjës i kishte dhënë urdhër shtabit të Armatës së dytë të blinduar, që për punë në minierat e Kosovës e të Shqipërisë të lë në dispozicion 400 italianë të zënë rob. Grupi i parë prej 100 robër arritën më 27 qershor të vitit 1944. Njëkohësisht u dërguan edhe 12 tonë tel gjembor dhe 4 tonë tel pa gjemba për të ndërtuar kampin për robër.⁶¹

Duke forcuar sigurinë e minierës, duke shtuar fuqinë punëtore dhe duke inkuadruar grupin special të kamionëve, prodhimi dhe dërgimi i xehes në muajt qershor, korrik dhe gusht u rrit dhe tejkaloi sasi të parashikuara me planin e hartuar në vjeshtën e vitit 1943. Në muajin qershor u prodhuan 6.396 tonë xehe, kurse në stacionet hekurudhore Pejë e Ferizaj u transportuan 5.275 tonë. Me hekurudhë në Gjermani u dërguan 4.678,5 tonë. Në deponitë pranë minierave dhe në ndërdeponitë të rrugët afruese, gjendeshin edhe 21.005 tonë xehe.⁶²

⁶⁰ NAW, T 77, R 1299, f. nr. 108, Ditari i luftës i Kisovit.

⁶¹ Komandanti i Divizionit SS „Skenderbeu“, s'ka dashur të japë njerëz për sigurim për të gjithë robërit italianë të luftës, dhe kjo detyrë iu ngarkua Korparmatës XXI alpiniste. (NAW, T 77, R. 1299, f. nr. 117, Ditari i luftës i Kisovit).

⁶² NAW, T 77, R 1299, f. nr. 245. Raporti i Kisovit mbi gjendjen në Shqipëri, dt. 23. VII. 1944.

Në qershor prodhimi u rrit dhe arriti në 8.045 tonë nga të cilat në zonën e Drejtorisë xehetare në Gjakovë 4.724 kurse në rajonin e Drejtorisë xehetare të Kukësit 3.321 tonë. Me kamionë deri në Pejë Ferizaj u hodhën 6.192 tonë, kurse në Gjermani u dërguan me hekurudhë 6.336 tonë.⁶³ Dërgimi më i vogël se prodhimi ndikonte në zmadhimin e mëtejshëm të sasisë së xehes në deponitë, e cila nga mbarimi i korrikut bënte 21.574 tonë.

Gjatë muajit korrik minierat e kromit i vizitoi inxh. i gjeologjisë Hizlajtneri. Aso rasti u vlerësua se në territorin e të dy drejtorive xehetare, të Kukësit e të Gjakovës, ka 76 — 94.000 tonë xehe të pasur përmbajtjeje 30-40% Cr₂O₃ dhe 85-92.000 tonë xehe të varfër përmbajtjeje 20-30% Cr₂O₃, që doemos duhej flotuar. Pos kësaj, u vërtetuan shtresa të mëdha të fshati Rahovec në lindje të Gjakovës. Përmbajtja e kësaj xeheje ishte 20-30% Cr₂O₃. Ekzistonte mendimi që kjo xehe të eksploatohet e të dërgohet në flotacionin të Shkupit.⁶⁴

Në gusht të vitit 1944 në territorin e drejtorive xehetare të Gjakovës e Kukësit, situata për gjermanët u keqësua dukshëm. Pas kalimit të Rumanisë në anën e koalicionit antihitlerian, pritej hyrja e Armatës së kuqe në Bullgari dhe dalja e kësaj prej Boshtit dhe hyrja në Koalicionin antihitlerian. Megjithatë gjermanët deri në ditët e fundit orvateshin të nxjerrin sa më tepër xehe e të krijojnë rezerva. Ata ia dolën që në gusht të arrijnë prodhim rekord në rajonet e Gjakovës e të Kukësit, që kapte 9.267 tonë xehe. Mirëpo, kjo gjë nuk solli efektet gjeologjike të dërgimi i xehes për Gjermani. Deri te stacionet hekurudhore Pejë e Ferizaj u transportuan gjithsej 5.203 tonë. Për këtë kanë pasur meritë sulmet e njësiteve partizane dhe të aviacionit aleat. Kështu, për shembull, me sulmin e aeroplanëve me fluturim të ulët më 13 gusht u nxorrën nga përdorimi 16 kamionë. Qe shkatërruar edhe një urë në rrugën Gjakovë — Pejë, që bëri të pamundshëm transportimin e xehes deri te ky stacion hekurudhor. Më njëzet gusht u bombardua stacioni hekurudhor në Pejë. U shkatërrua ndërtesa dhe u prishen binarët. Në të njëjtën kohë njësitë partizane sulmuan minierat në Zogaj, Letaj, Kam dhe Kepenik.⁶⁵

Kah mesi i gushtit ngjau depërtimi i forcave të fuqishme të UNÇJ prej Malit të Zi në Luginën e lumit Ibër. Kjo pati për pasojë ndërprerjen e komunikacionit në hekurudhën Ferizaj — Mitrovicë — Rashkë — Krlevë, kështu që edhe dërgimi i xehes u pengua. Për të gjitha këto, dërgimi i xehes për Gjermani, në gusht bënte vetëm 4.635 tonë. Kjo do të thotë se prej hyrjes së trupave gjermane në territorin, që deri në kapitulum mbanin trupat italiane, e deri në fund të gushtit 1944, nga treva e minierave në rrethinat e Kukësit e të Gjakovës për Gjermani qenë dërguar 30.498,2 tonë xehe kromi.⁶⁶

⁶³ Njësoj, f. nr. 250-251, Raporti i Kisovit për gjendjen në Shqipëri, dt. 21. VIII. 1944.

⁶⁴ Njësoj, f. nr. 249-250.

⁶⁵ Njësoj.

⁶⁶ Shih tabelën 3.

⁶⁷ NAW, T 77, R 1299, f. nr. 114, 115, Ditari i luftës i Kisovit.

Ndërtimi i hekurudhës binarëngushtë Pejë — Gjakovë

Gjatë eksplotimit italian të minierave të kromit te Kukësi e Gjakova, xehja transportohej me kamionë nëpër krahinën veriore malore të Shqipërisë deri te bregorja, ku ngarkohej në anije dhe dërgohej në Itali. Qysh atëbotë ka pasur vështirësi në transport për arsye të mungesës së kamionëve dhe të gomave për rrota si dhe të rrugëve të këqia, kështu që në rrjedhën e dimrit, prodhimi në miniera qe ndërprerë. Qysh gjatë negociatave me kompaninë italiane AMMI nga fundi i vitit 1942 për mundësinë e zmadhimit të prodhimit të xehes së kromit dhe për cesimin (lënien) e një pjese Gjermanisë, është bërë fjalë për nevojën e ndërtimit të hekurudhës binarëngushtë prej Pejës deri në Gjakovë. Kjo ide as më vonë, kur eksplotimin e minierave e mori Gjermania, nuk u braktis. Nga të dhënat e sjella më lartë, shihet qartë se transportimi me kamionë s'ka mundur kurrsesi të kënaqë nevojat në dërgimin e xehes, kështu që sasia e xehes në deponitë pranë minierave përherë rritej. Transportimi i kësaj xeheje u bë akut pas ndërprerjes së dërgesave turke, kur pikërendimi për furnizimin e industrisë gjermane të luftës me xehe kromi, u vu shë mbi minierat në Maqedoni, në Kosovë dhe në Shqipëri. Prodhimi i shtuar gjatë muajve pranveror të vitit 1944, s'ka mundur të transportohet deri te stacionet hekurudhore të Pejës e të Ferizajit edhe përkundër faktit se për këtë qëllim qenë ndarë 194 kamionë si grup special i transportit për transportimin e xehes së kromit. Shkak i kësaj dukurie, veç rrugëve të këqia, pengimit të përhershëm të transportit nga ana e njësiteve të ushtrive nacionalçlirimtare të Shqipërisë dhe të Jugosllavisë si dhe të aviacionit anglez, është edhe kapaciteti i vogël i kamionëve. Fjala është se, këta kamionë kishin tonazh prej 1 deri 1,5 tonë. Së këndejmi edhe shfaqej vështirësia rreth furnizimit të kamionëve me karburante. Sipas të dhënave që ka sjellë udhëheqësi ushtarak ekonomik Kisovi, për transportimin e një ton xehe kromi prej Kukësit deri në Pejë, duhej deomos të shpenzoheshin 60-80 litra karburant dizel. Sikur kamionët të ishin kapaciteti prej 5 ton, atëherë shpenzimi i karburantit për një ton xehe do të pakësohej në 20 litra, e sikur kamionet të kishin rimorkio, atëherë shpenzimi do të zvogëlohej, për më tepër, në 12 litra karburant për një ton xehe të transportuar. Mirëpo, me ndërtimin e hekurudhës prej Pejës deri në Gjakovë, do të zvogëlohej shumëfish shpenzimi i karburantit dhe do të shtohej mundësia e transportimit të xehes. Veç kësaj, prej ndërtimit të kësaj hekurudhe pritej një furnizim më i mirë edhe i njërive të divizionit SS „Skenderbeu” si dhe i njërive të tjera të dislokuara në zonën e minierave të kromit.⁶⁷

Së pari u planifikua ndërtimi i 48 km me binarë gjerësie 70 cm prej Pejës deri në Gjakovë, me qëllim që më vonë binari të zgjatet deri në Kukës dhe në këtë mënyrë të lidhet drejtpërdrejt treva e pasur me xehe me stacionin hekurudhor në Pejë. Leja për fillimin e ndërtimit të hekurudhës u dha në mars të vitit 1944 dhe këshilltari i lartë ushtarak-administrativ

⁶⁷ NAW, T 77, R 1299, f. nr. 114, 115. Ditari i luftës i Kisovit.

gjenerali Krone, mori urdhër të sigurojë 200.000 franga shqiptare për pagesat e para, kurse financimi i mëtejshëm duhej të shkonte përmes kompanisë Südost-Montan.⁶⁸ Deri në mesin e prillit të vitit 1944, qenë kryer punimet rreth fotografimit të parë të trasës.⁶⁹ Kryerja e punëve ndërtimore iu bësua organizatës Tot, e cila gjatë prillit të vitit 1944 tashmë kishte filluar punimet përgatitore.

Për të pasur fotografinë e vërtetë të gjendjes dhe për të shpejtuar punimet, më 22 prill u mbajt një këshillim, ku morën pjesë përfaqësuesit e udhëheqësit ushtarakë ekonomikë të Armatës së dytë të blinduar, kapiteni dr Redenbek, të kompanisë Südost-Montan Nojlandi (Neuland) dhe Laurici (Lauritz), të organizatës Tot Shrimpfi (Schrimpf) inxh. Tile (Thiele) dhe të batalonit 26 teknik minator, togeri Shulci (Schultz). U konstatua se aso kohe prej gjithsejt 48 km shina, tashmë ishin sjellë 30 km, kurse 18 km e tjera ishin porositur te prodhuesit dhe pritej që së shpejti të arrijnë. Për vendosjen e shinave nevojiteshin 100.000 traversa të druja. Deri në mbajtjen e këtij këshillimi, Südost-Montani dhe organizata Tot te një tregtar shqiptar me lëndë druri kishin blerë 10.000 dhe rreth 20.000 ishin kontraktuar dhe ishin të gatshëm për dërgim.⁷⁰

U vlerësua se për ndërtimin e hekurudhës nevojiten 4-4,5 muaj, prej të cilëve një muaj për matjen definitive dhe trasimin e vijës, që duhej kryer prej një grupi të organizatës Tot me në krye gjeodetin inxhinierin Tile, kurse 3 deri më 3,5 muaj për ndërtimin e shtresës së poshtme dhe vendosjen e shinave. Për të kryer këto punë brenda këtij afati, është dashur të sigurohen 1.500 deri më 1.700 punëtorë. Meqë personave civilë, sikur të angazhoheshin në ndërtimin e hekurudhës, është dashur t'u paguhen mëditjet me lekë shqiptarë, të cilët Gjermania i gjente vështirë, për çka u fol më përpara, kapiteni Redenbek në emër të udhëheqësit ushtarak të ekonomisë Kisovit, propozonte për punë të perdorën robërit italianë të luftës dhe njësitet gjermane të inxhinierisë, sepse hekurudha, sidomos pas zgjatjes së saj deri te Kukësi, do të kishte një rëndësi të madhe për sjelljen e artikujve të konsumit, të materialit të luftës e materialit tjetër, trupave gjermane që gjendeshin në Shqipëri.⁷¹

Për tërheqje në hekurudhë që parashikuar përdorimi i lokomotivave me avull, për të evituar shpenzimin e naftës deficitare. Mirëpo, meqë në këtë terren nuk ekzistonte ndonjë minierë thëngjilli kualiteti përkatës, dhe ky do të duhej sjellë prej Gjermanisë, gjë të cilën po ashtu nuk e lejonin rethanat e transportit, u vendos që në fillim të përdoren lokomotivat dizel, që do të

⁶⁸ NAW, T 77, R 1299, f. nr. 79, Shënimet e shefit të Shtabit ushtarak-ekonomik për Juglindje mbi vizitën inspektuese të datës 9-19. III. 1944 v.

⁶⁹ Këtë punë për llogari të kompanisë gjermane Südost-Montan e kreu një inxhinier italian. Rezultatet e këtij fotografimi të parë iu dorëzuan Organizatës TOT, grupi i së cilës për matje, ka pasur për detyrë të caktojë definitivisht trasën.

⁷⁰ Pasi u konstatua se ofertat që kishte marrë Organizatat TOT parashikojnë çmime dy deri më tri herë më të larta se çmimet me të cilat kompania Südost-Montan blinte pragje, u vendos që kontratat për blerjen e pragjeve t'i lidhë Südost-Montani ose ofertat t'i gjejnë blerësit e saj dhe t'i dorëzojnë organizatës TOT.

⁷¹ Për vendosjen e fuqisë punëtore në hekurudhë, u vendos të merret manastiri i Deçanit, mandej, shkolla fillore në Deçan, dhe shtëpitë e braktisura që gjendeshin në afërsi të trasës. Pos kësaj, Organizata TOT dispononte edhe 30 tenda të mëdha dimërore (Finnenzelte).

thoshte një shpenzim dhjetë fish më të vogël të naftës në krahasim me sasinë që shpenzonin kamionët për transportimin e së njëjtës sasi xeheje.

Vështirësitë ekzistonin edhe me blerjen e materialit ndërtimor për ndërtimin e objekteve të hekurudhës. Organizata Tot priste se çimentoja do të mund të merrej prej fabrikës së çimentos në Shkodër, kurse gëlqerja prej gëlqerores të Gjakova. Mirëpo, kapiteni Redenbek mbronte pikëpamjen se lypset ndërtuar me materie të mbetura (mbeturinash) që përftohet gjatë punimeve në trasë dhe objektet të ndërtohen prej guri të thyer, pse në këtë rast në vend të llaçit mund të shfrytëzohet edhe balta. Ai bënte me dije se nuk duhet përmbytur kritereve të kohës së paqes, por duhet ndërtuar hekurudhën sa më parë, sepse ajo është e një rëndësie vendimtare për luftë (von kriegsentsche eidender Bedeutung), përpos se prej saj priten edhe kursime të shënueshme në karburante dhe goma automobilistike.⁷²

Pasi u kryen matja dhe trasimi, punimet në hekurudhë filluan më 13 korrik 1944. Mirëpo, së shpejti u shfaqën vështirësi rreth financimit, kështu që punimet u ngadalësuan mjaft dhe afatet e parashikuara që në fillim, u bënë të pasendërtueshme. Çmimi i përgjithshëm i kostos së ndërtimit të pjesës së hekurudhës deri në Gjakovë, u vlerësua në 8 milionë franga shqiptare, dhe prej gjysmës së gushtit qenë siguruar vetëm një milion. Prej këtyre, 300.000 u ndanë për blerjen e pragjeve të drunjtë dhe 700.000 iu lanë në disponim Organizatës Tot për financimin e punëve ndërtimore. Andaj, deri në fund të korrikut punimet kishin ngelur në fazën fillestare. Për shkak të nevojës së madhe për dërgimin e xehe në gjermani, organizata Tot numrin më të madh të njerëzve i kishte ndarë për ndreqjen (meremetimin) e rrugës Gjakovë — Pejë.⁷³ Zhvillimi i ngjarjeve në fronte që detyroi Gjermaninë të tërhiqej prej Ballkanit, bëri që të bie poshtë çdo mundësi e punimeve të mëtejme në hekurudhë.

Ndërprerja e prodhimit në minierat e kromit dhe çaftësimi i tyre

Nga fundi i gushtit dhe fillimi shtatorit të vitit 1944 presioni i forcave nacionalçlirimtare u bë aq i fuqishëm sa që pozita e njësiteve gjermane teknike dhe e njësiteve për sigurimin e minierave në Maqedoni, Kosovë e Shqipëri u bë e paqëndrueshme. Nën këtë presion, qysh nga fundi i gushtit njësitet për sigurimin e minierave në përfundim të Pogradeci u detyruan të tërhiqeshin. Me urdhërin e Shtabit të Korparmatës XXI alpiniste, më 28 gusht e braktisën minierën Mamelishtë edhe njëerëzit (ekipazhi) e batalonit minator „Juglindja”. Ata kishin marrë urdhër që me vete të merrnin gjithë materialin e rëndësishëm si dhe makinat dhe t’i sillnin në Strugë. Ky urdhër u zbatua të njëjtën ditë. Në kohën prej 2 deri më 5 shtator, ky material u hodh prej Strugës në Manastirë, për t’u dërguar prej këndeje në Gjermani.⁷⁴

⁷² NAW, T 77, R 1299, f. nr. 127-130.

⁷³ Njësoj, f. nr. 197 dhe 245. Raporti i Kisovit dt. 15. VII dhe 21. VIII. 1944.

⁷⁴ NAW, T 77, R 1296, f. nr. 435, Raporti i batalonit mintor „Juglindja” për muajin shtator 1944.

Pas marrjes së pajisjeve prej minierës Mamelishtë, u ngarkuan edhe materiali e pajisja prej depos së Prrenjasit. Kolona e cila më 31 gusht transportonte këtë material për Strugë, u sulmua prej aeroplanëve anglezë dhe një kamion qe shkatërruar. Më 5 shtator, kur deshti të hudhë këtë material për Manastir, kjo kolonë qe sulmuar prej forcave nacionalçlirimtare të Maqedonisë te Struga. Gjermanët nuk patën mjaft forca për të prapsuar sulmin dhe u detyruan të heqin dorë prej transportimit të këtij materiali.⁷⁵

Më 7 shtator prej Pogradecit u tërhoq një kolonë e fundit e kamionëve nën komandën e togerit Shajl, e përbërjes së Grupit special të transportit „Juglindja” dhe mori pajisjet dhe materialin e i çoi në Ferizaj.⁷⁶

Edhe në territoret e drejtorive xehetare në Gjakovë dhe në Kukës, partizanët kryenin sulme të pandërprera mbi minierat. Më 9 shtator ata sulmuan minierën Seroj.⁷⁷ Dy ditë më vonë, një aradhë partizane, sipas vlerësimeve gjermane, prej 800 deri më 1.000 njerëz, sulmoi minierat Deva dhe Zogaj. Minierat Kam dhe Kepenik aso kohe qenë izoluar plotësisht.⁷⁸

Edhe xeherorja „Jezerine” në Luboten, u braktis më 6 shtator prej grupit të batalionit xehetar „Juglindja”, që atje punonte dhe u tërhoq në Brezovicë. Ky grup më 8 shtator, duke luftuar, depërtoi deri në Ferizaj.⁷⁹

Për shkak të situatës së këtillë shefi i shtabit ushtarak ekonomik për Juglindje, gjenerali Braumyleri, më 7 shtator, prej Planit katërvjeçar dhe Ministrisë së ekonomisë së luftës kërkoi instruksione rreth çështjes së qëndrimit të mëtejme mbi eksploatimin e minierave në Ballkan. Përshkak të paralizimit të komunikacionit hekurudhor, dërgimi i xehes për Gjermani u bë i pamundshëm, kështu që prodhimi i mëtejme për këtë arsye ishte i paqëllimtë. Ai shtroi edhe pyetjen se a duhet dhe cilat miniera të shkatërrohen. Qysh më 8 shtator iu transmetua urdhëri i Geringut që prodhimi i minierave, që nuk mund të mbahen, të ndërpritet, që minierat të mos minohen, por pajisja të çmontohet e të merret ose të çaftësohet duke hequr dhe mshehur pjesë të rëndësishme, kurse pusët xeherore të përmythen dhe kësisoji të çaftësohen për prodhim. Ky urdhër u përkiste të gjitha minierave të kromit në Maqedoni, në Kosovë dhe në Shqipëri, e po ashtu dhe minierave të tjera në Serbi, duke përfshirë edhe minierën e Borit. Ky urdhër u dha me shpresë se gjermanët do të ktheheshin sërish, e pos kësaj, shkatërrimi i minierave nuk do t'i shkaktonte kurrfarë dëmi të ndieshëm ekonomisë luftarake të fuqive aleate, pse ato posedonin burime lëndësh të para edhe në të tjera pjesë të botës, që ishin jasht cakut të

⁷⁵ Njerëzimi i batalionit minator „Juglindja”, lanë transportin dhe depërtuan deri në Manastir, ku arritën më 8 shtator. Kështu, të gjithë materialin dhe pajisjen që dispononin, që më përpara ishte çuar në Manastir, ia dorëzuan depove ushtarake, kurse njerëzimi më 9 shtator u nisën për Beograd përmes Prilepit. Meqë më 9 shtator u bë përmbysja në Bullgari, gjermanët deshtën të çarmatosnin njësitet bullgare në Prilep, për ç'arsye ngjau një përlëshje gjermano-bullgare, kështu që njerëzit e batalionit minator më 11 shtator u kthyen në Manastir (Bitol) dhe në Beograd arritën vetëm më 30 shtator. (NAW, si në vërejtjen nr. 74).

⁷⁶ NAW, T 77, R 1299, f. nr. 217. Ditari i luftës i Kisovit.

⁷⁷ Kisovi shkruan në Ditarin e tij të luftës se bashkë me këtë njësit partizan, ishin edhe përfaqësuesit ushtarakë anglezë dhe sovjetikë.

⁷⁸ Në këto luftime kompania gjermane për sigurim, ka pasur 14 të vranë, 11 të plagosur dhe tre ushtarë të zhdukur. (NAW, si në vërejtjen 76).

⁷⁹ NAW, si vërejtja 74, f. nr. 430.

shkatërrimeve luftarake. Përjashtim ishte „Trepça”. Për këtë minierë Geringu kishte dhënë një urdhër të veçantë që të shkatërrohen si pusët ashtu edhe shkëmborja.⁸⁰

Një ditë më vonë, më 9 shtator, edhe shefi i administratës ushtarake, kishte marrë leje me telefon prej Ministrisë së ekonomisë dhe Buros për Planin katërvjeçar, që prodhimi në miniera të ndërprehet, për të mos u zmadhua vetëm sasia e xehes në depo, që nuk mund të transportohet në Gjermani, por vetëm po lidh për vete forca të ndieshme ushtarake për sigurim. Këto forca është dashur të tërhiqen dhe të përdoren për detyra operative ushtarake. Kishte marrë urdhër që me çdo mënyrë të vazhdojë prodhimin dhe transportimin vetëm të antimonit, kurse në Bor e Trepçë të mbahen vetëm repartet më të domosdoshme të stabilimeteve, për të mos u fikur furrat, përderisa atje të gjenden forcat ushtarake gjermane.⁸¹

Në bazë të këtyre urdhërave, gjenerali Braumyer tërhoqi të gjitha njësitë për sigurim dhe njësitë teknike, si dhe personelin tjetër nga minierat e zonave rreth Kukësit e Gjakovës. Prej 10 shtator të gjitha këto miniera si dhe minierat në perëndim të Liqenit të Ohrit, gjermanët ia lanë në dispozicion qeverisë së Tiranës, e cila në atë kohë s’ka ushtruar kurrfarë ndikimi në këto treva. Kompania e batalonit ushtarak-ekonomik për sigurim „Kroatien”, që hudhur në minierën e thëngjillit afër Bella Cërkvës te Lloznica, e cila furnizonte me qymyr minierën e antimonit Zajaça, prodhimi i së cilës, sipas urdhërit të Ministrisë së ekonomisë dhe të Planit katërvjeçar, doemos duhej të mbahej me të gjitha mjetet deri në momentin e fundit. Kompania teknike e batalionit 26 minator u hodh në minierën e thëngjillit të Kollubarës Vreoci, prodhimi i së cilës ishte i rëndësishëm për të furnizuar centralet elektrike në Beograd. Ajo me vete mori të gjithë kamionët ushtarakë si dhe kamionët e kompanisë Südost-Montan dhe tërë pajisjen që mundi ta ngarkonte në kamionë. Ato që nuk mundën të merren u asgjësuan. Pusët xeherore u çaftësuan për prodhim, të shumtën duke i përmbytur në ujë dhe duke stërshpërndarë dhe zhdukur pajisjen e tyre. Bashkë me këtë kompani minatore, prej Shqipërisë u tërhoq edhe i autorizuari për miniera të xehes metalike në Shqipëri, këshilltari i lartë ushtarak-administrativ Krone me tërë personelin.⁸²

Në seancën e datës 11. IX. 1944, ku asistuan komandanti i Juglindjes feldmareshali von Vajks dhe shefi i Shtabit ushtarak-ekonomik për Juglindje

⁸⁰ NAW, T 77, R 1296, grupi i dokumenteve të fondit OKW, Serbien, Montenegro, Bd. I, Feldwirtschaft, f. nr. 395-405. Në Trepçë mbeti grupi i kompanisë së dytë të batalonit minator „Juglindja” prej 17 vetash. Për mungesë qymyri dhe për shkak të bllokadës së partizanëve, repartet nuk punonin. Detyrë e këtij grupi ishte të përgatis çdo gjë për shkatërrimin e reparteve. Mirëpo, ai informoi se këtë gjë s’është në gjendje ta bëjë vetë dhe kërkoi ndihmë, kështu që më 18. IX. 1944 në Trepçë u dërguan edhe dy grupe nga Maqedonia. (NAW, T 77, R 1296, f. nr. 430, Raporti i komandantit të Batalionit minator për muajin shtator 1944). Kështu, numri i njerëzve u rrit në 36 sish. Kur prej Greqisë u tërhoq kompania e tretë e batalonit 26 teknik të motorizuar „Xehetaria”, e cila punonte në minierën e molibdenit Navro Bendro te Axiopolisi në Greqinë veriore, ajo u dërgua në Trepçë për të zëvendësuar kompaninë e batalionit minator „Juglindja” dhe të përfundojë përgatitjen për rrënimin e minierës. (NAW, T 77, R 1296, f. nr. 458, Raporti i oficerit të lartë ushtarak-ekonomik pranë Komandës supreme të Juglindjes, datë 8. X. 1944).

⁸¹ Njësoj, f. nr. 474-476.

⁸² NAW, T 77, R 1299, Raporti i Kisovit mbi gjendjen në Shqipëri për muajin shtator 1944.

gjenerali Braumyler, u mor vendim që prodhimi të ndërpritet në të gjitha minierat e Juglindjes, duke përfshirë minierat „Trepça” dhe „Bor” si dhe minierat e kromit në Kosovë, Maqedoni, Shqipëri dhe Greqi.⁸³

Mirëpo, Shtabi operativ i Komandës supreme (Wehrmachtsführungssab — OKW), me telegramin nr. 2/44 dt. 21. IX. 1944, dha urdhër që minierat e kromit në Maqedoni (nuk përmend minierat në Kosovë e Shqipëri) si dhe miniera e bakrit Bor — doemos duhen siguruar, pa marrë parasysh se a do të mund të vazhdojë apo të fillojë sërish prodhimi tashmë i ndërprerë, dhe shfuqizoi masat për braktisjen e këtyre minierave. U dha urdhër që të dërgohet në Gjermani çfarëdoqoftë sasi të xehes e të metaleve. „Çdo ton kromi e bakri ka rëndësi të madhe për armatim”, precizonte (saktësonte) Shtabi kryesor i Wehrmachtit.⁸⁴

Edhe Komanda supreme e vermahtit (OKW) më 3 tetor i dha urdhër Grupit të armatave „E” që në tre muajt e ardhshëm prej Beogradit të liferohet një sasi sa të jetë e mundur më e madhe e xehes së Kromit për shkak të rëndësisë së saj të jashtëzakonshme për industrinë gjermane të luftës. Supozimi për këtë ishte që të jenë të mundshme komunikacioni hekurudhor dhe lundrimi në Danub.⁸⁵ Shefi i gjeneralshtabit të Grupit të armatave „E” kërkoi raport prej Shtabit ushtarak-ekonomik për Juglindje se ç’sasi xehe kromi mund të liferohen në Gjermani përmes Beogradit në tre muajt e ardhshëm. Shtabi ushtarak-ekonomik më 3 tetor raportoi se në Ballkan gjenden këto sasi xehe të kromit, që do të mund të transportoheshin në Gjermani:

1. Në Selanik	200 tonë
2. Në deponinë në minierën Radusha dhe te flotacioni pranë Shkupit	5.000 ”
3. Në Kaçanik (në minierën Jezerine)	500 ”
4. Në stacionin hekurudhor në Pejë	1.000 ”
5. Në stacionin hekurudhor në Ferizaj	1.000 ”
6. Ngarkuar në vagonë që gjendeshin në hekurudhën në jug të Mitrovicës	2.500 ”

Pra, në deponitë pranë stacioneve hekurudhore dhe tashmë të ngarkuara në vagonë, kishte 10.200 tonë xehe. Veç kësaj, në flotacionin te Shkup kishte 50 tonë koncentrat 50%.

Përveç kësaj sasi të xehes, që ka qenë e mundur të ngarkohet menjëherë në vagonë, Shtabi ushtarak-ekonomik raportonte se ekzistojnë edhe këto sasi xeheje në deponitë në rajonin e minierave deri te cilat ishte i mundshëm komunikacion i kamionëve (ndërdeponitë). Ishin këto sasi xeheje:

⁸³ Si vërejtja 80, f. nr. 390.

⁸⁴ NAW, si në vërejtjen 80, f. nr. 385.

⁸⁵ Njësoj, f. nr. 381.

1. Te miniera „Jezerine”	500 tonë
2. Te miniera Rabrovo te Vallandova	500 ”
3. Në ndërdeponitë te Kukësi	2.500 ”
4. Në rrugët kalimtare pranë puseve të ndryshme në rajonin në perëndim të Gjakovës	1.500 ”

Pra në ndërdeponitë gjithsejt ka pasur 5.000 tonë xehe. Për transportimin e kësaj xeheje deri në stacionet hekurudhore, është dashur siguruar kamionët dhe sigurinë e duhur ushtarake, sepse edhe kamionat edhe njësitët për sigurim tashmë ishin tërhequr nga këto treva.

Veç 15.200 tonë xehe në ndërdeponitë dhe stacionet hekurudhore, ekzistonte edhe një sasi e madhe xeheje te vetë pusët e minierave. Mirëpo, transportimi i saj deri te ndërdeponitë, respektivisht deri te rrugët afruese deri ku mund të vinin kamionët, nuk ka qenë i mundshëm, sepse teleferikët prej puseve deri te këto deponi, ishin të shkatërruara ose gjendeshin nën sulme të pandërprera të partizanëve nga fundi i gushtit dhe fillimi i muajit shtator, ose prej gjermanëve në çastin e braktisjes së minierave. Shtabi ushtarak-administrativ raportonte se në tre muajt e ardhshëm s’është e mundur të përtërihen këto stabilimente, dhe, prandaj, nuk duhet llogaritur me këtë xehe kromi.⁸⁶

Mirëpo, të gjitha këto plane u treguan si iluzion i thjeshtë. Meqë urdhërat për transportimin e xehes së kromit në tre muajt e ardhshëm, vinin prej instancave më të larta ushtarake, mund të konkludohet se ato ushqenin shpresë se trupat gjermane kanë për të qëndruar në këtë pjesë të Gadishullit ballkanik dhe në Beograd deri në fund të vitit 1944. Mirëpo, vetëm disa ditë më vonë, depërtimi i forcave të fuqishme të Ushtrisë nacionalçlirimtare të Jugosllavisë në rajonin në jug të Beogradit, ndërpreu të vetmen lidhje hekurudhore të rajonit xeheror me Beograd, e pra edhe me Gjermani, kështu që të gjitha shpresat për dërgimin e sasive të përmendura të xehes, dështuan.

⁸⁶ Njësoj, f. nr. 382-383.

Tabela 1

P a s q y r ë

e prodhimt të parashikuar të xehes së kromit në vitin 1944 që nuk duhet flotuar

Emri i minierës dhe treva	Koncentrat 50%	Xehe 40%	Xehe 35-40%	Xehe 30%	Xehe 25-30%	Gjithsejt tonë
1. Allatini mines dhe Luboteni	—	22.400	—	3.000	—	25.900
2. Mihja ditore Nada	—	24.000	—	—	—	24.000
3. Llojani	—	1.700	—	1.900	—	3.600
4. Flotacioni në Radushë	10.000	—	—	—	—	10.000
Gjithsejt 1 — 4	10.000	48.100	—	5.400	—	65.000
5. Jezerine dhe pusët rreth saj	—	12.000	—	3.600	—	15.600
6. Vallandova	—	5.000	—	—	—	5.000
7. Preshevë-Ostravicë	—	—	—	—	—	—
8. Flotacioni te Shkupi	23.000	—	—	—	—	23.000
Gjithsejt 5 — 8	23.000	17.000	—	3.600	—	43.000
Në zonën bullgare të pushimit gjithsejt 1 — 8	33.000	65.100	—	9.000	—	107.000
9. Domoskos	—	—	20.000	—	—	20.000
10. Chalkidike	—	—	1.000	—	11.000	12.000
11. Pusët-Olymp	—	—	7.000	—	1.000	8.000
Gjithsejt në Greqi 9 — 11	—	—	28.000	—	12.000	40.000
12. Gjakovë-Letaj	—	20.000	—	3.000	—	23.000
13. Kukës	—	6.000	—	3.000	—	9.000
14. Klosi	—	10.000	—	—	—	10.000
15. Pogradeci	—	8.000	—	2.000	2.000	10.000
16. Rahoveci	—	—	1.000	—	1.000	—
Gjithsejt në Kosovë dhe në Shqipëri (territ. i „Shqipërisë së Madhe” 12 — 16:	—	44.000	—	9.000	—	53.000
17. Kralevë-Rashkë	—	1.000	—	—	—	1.000
Gjithsejt në territorin e Serbisë së Nediqit	—	1.000	—	—	—	1.000
Gjithsejt në territorin e Jugosllavisë, të Greqisë dhe të Shqipërisë së okupuara 1 — 17:	33.000	110.100	28.000	18.000	12.000	201.100
Përmbajtja Cr ₂ O ₃	16.500	44.040	10.500	5.400	3.300	80.040
Përmbajtja e metalit të pastër						54.427

Tabela 2

P a s q y r ë

E prodhimit të parashikuar të xehes së varfër përmbajtjeje 17 deri më 20% Cr₂O₃, që doemos duhet flotuar (në tonë)

Emri i minierës dhe treva	Prodhimi i planifikuar	V ë r e j t j e
1. Allatini-Luboteni	55.500	Sasi me gjasë
2. Mihja ditore Nada	5.000	
3. Llojani	7.100	
Gjithsejt 1 — 3:	67.600	
4. Jezerina dhe pusët përreth	10.800	Rritja e mundshme
5. Vallandova	400	
6. Presheva dhe Ostrovica	3.000	
Gjithsejt 4-6:	14.200	
Gjithsejt në terr. e okup. bullg	81.800	
7. Domoskos	2.000	
8. Chalkidike	2.000	
9. Pusët-Olymp	1.000	
Gjithsejt në Greqi 7-9:	5.000	
10. Gakovë-Letaj	2.000	E pasigurtë për pozitën E pasigurtë për kontrollin Nga ana e forcave NÇ E pasigurt për pozitën
11. Kukësi	3.000	
12. Klosi	2.000	
13. Pogradeci	2.000	
14. Rahoveci	5.000	
Gjithsejt 10-14:	14.000	
15. Krlevë-Rashkë	—	Ndoshta disa qinda tonë
16. Bandolo	2.000	
Gjithsejt në territorin e Serbisë së Nediqit, 15-16:	2.000	
GJITHSEJ në territoret e okup. të Jugosllavisë, Greqisë dhe të Shqipërisë 1-16:	102.000	

Tabela 3

P a s q y r ë

E prodhimit dhe e dërgimit të xehes në Gjermani brenda kohës prej tetorit 1943 deri më gusht 1944

Muaji	Prodhimi Gjakovë-Kukës	Prodhimi në rajonin e Pogradecit	Transporti prej Pejës për Gjermani	Transporti prej Struge dhe Manastiri
Tetor	350	—	2.500	—
Nëntor	480	—	1.540	—
Dhjetor	800	—	1.100	350
Janar 1944	1.305	—	1.032	1.165
Shkurt	1.874	—	682,5	—
Mars	3.282	—	1.642,5	—
Prill	4.358	—	3.153	—
Maj	5.198	—	3.198,5	—
Qershor	6.395	—	4.678,7	—
Korrik	8.045	117,5	6.336	—
Gusht	9.267	430	4.635	112
Gjithsejt:	43.295	547,5	30.508,2	1.527

V ë r e j t j e: Nga teksti shihet se përpjekjet për transportimin e xehes në Gjermani, bëheshin edhe gjatë muajve shtator dhe tetor. Prej dokumenteve janë konstatuar sasitë e xehes që gjendeshin në stacionet hekurudhore ose që ishin të ngarkuara në vagonë, por autori, nga materiali që ka disponuar, s'ka mundur të përcaktojë se a ia kanë dalë gjermanët gjatë këtyre muajve ta dërgojnë xehen në sasi kaq të madhe në Gjermani, dhe së këndejmi edhe shifrat e sipërme duhet konsideruar si sasi të përafërsishme të xehes së dërguar në Gjermani, kurse sasia e xehes së prodhuar është definitive, nga se në shtator më s'ka pasur prodhim, sepse ishte e qartë se nuk do të mund të dërgohet në Gjermani as xehja tashmë e mihur.

Živko Avramovski

L'EXPLOITATION DES MINES DE CHROME DANS LE DISTRICT DE GJAKOVA (DJAKOVICE) ET DE KUKS, APRES LA CAPITULATION DE L'ITALIE (1943-1944)

R é s u m é

Sur la base des documents non édités des Archives de Politisches Archiv des Auswartiren Amtes à Bonn, des documents allemands microfilmés à National Archiv à Washington, Vereingte Deutsche Betriebsarchin der Kaliindustrie a Stassfurt-Republique Democratique d'Allemagne et de Public Rekard Office à Londres, l'auteur souligne

l'importance de la mine du chrome au sud est de l'Europe pour la fourniture de l'industrie allemande de la guerre avec ce métal très important. A ce point de vue, le district de Gjakova à Kosovo et celui de Kurs et de Klosa au nord de l'Albanie, occupaient une place très importante. L'importance de ces mines augmenta à partir du mois d'avril 1944, quand la Turquie ne livrait plus de chrome à l'Allemagne. Ces livraisons avaient commencé le 1. janvier 1943.

Sur la base de ces documents de source, l'auteur donne la primauté de toutes les mesures que l'Allemagne nationaliste a prises par l'intermédiaire de ses organes et de ses services militaires de l'état et des sociétés économiques pour l'habilitation des mines à fabriquer sans arrêt, pour assurer la main d'œuvre, les moyens de transports, les matériaux à reproduire et pour assurer la défense de la mine des attaques permanents de l'armée de libération nationale de Yougoslavie et de l'armée Nationale d'Albanie. D'un tel comportement l'auteur a réussi de reconstruire tout le cycle de la production et de vérifier les quantités mensuelles de la mine, en commençant du mois de septembre 1943, quand les allemands ont occupé ces territoires, jusqu'à sa retraite, une année après. De même, on a vérifié la quantité du chrome, expédié en Allemagne par le chemin de fer.

De ces données on peut voir que l'Allemagne a réussi une production de 43.295 tonnes de chrome à la période du octobre 1943 jusqu'en août 1944. Alors, la production a augmenté au mois d'octobre de 350 tonnes à 874 tonnes au mois de février 1944. Au mois de mars, on avait produit 3.282 tonnes et au mois d'août c'est le record: 9.267 tonnes. Tout cela subvenait 50% des besoins mensuels de l'industrie militaire de l'Allemagne.

L'expédition de la matière première n'était pas satisfaisante. A cause des difficultés de transport, surtout à cause des détériorations des moyens de transport de la part de ses alliés et des puissances populaires de Yougoslavie et d'Albanie, les allemands ont expédié seulement 30.000 tonnes. Le reste de la production était enfermée dans les magasins de la gare à Pejë (Pec).

Comparablement avec la production et l'expédition du chrome, l'auteur a élaboré l'aspect politique des rapports entre l'Allemagne et l'Italie avant sa capitulation, concernant les droits d'exploitation des mines de chrome en Grèce, les montagnes de Sharr (Šar) et de même la question des rapports entre l'Allemagne et les organes du gouvernement kvislin à Tiranë, formé tout de suite après la capitulation de l'Italie.